



**Marrëveshje Bashkëpunimi  
midis  
Organizatës “ Te Ndryshëm & Të Barabartë” dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga  
Diskriminimi**

**Hyrje**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është institucionalizimi i bashkëpunimit mes dy subjekteve, Organizatës “ Të Ndryshëm & Të Barabartë” dhe **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi** si dhe përcaktimi i roleve të secilës palë gjatë kohës së bashkëpunimit.

**Palët në Marrëveshje:**

**Organizata “ Te ndryshem dhe Te barabarte”** me seli në Rr. Milto, Tutulani, Pall. Alb – Milenium, kati 6, ap.39, Tiranë, këtu referuar si D&E, përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive **Znj. Mariana Meshi**

Dhe

**Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi** me seli në Rr: Sami Frashëri, Nr 10, Kati II, Tiranë, përfaqësuar nga Komisionerja **Zj. Irma Baraku**.

**Objekti I Marrëveshjes:**

Objekti i marrëveshjes është realizimi i aktiviteteve të përbashkëta për të rritur respektimin e të drejtave të viktimave të trafikimit në Shqipëri, të ndërmarra në kuadër të projektit me titull **“Respektimi i të drejtave të viktimave të trafikimit në Shqipëri - TI JAPIM FUND STIGMËS”**.

## Përgjegjësitë e Paleve

### Përgjegjësitë e D&E

1. Të koordinojë aktivitetet e ndryshme ndërgjegjësuere që synojnë të rrisin njohuritë e komunitetit mbi të drejtat e veta në Shqipëri.
2. Të parashikojë një sesion të posaçëm brenda aktiviteteve ndërgjegjësuere për ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për rolin specifik të institucionit të KMD.
3. Të ofrojë mbështetje logjistike për specialistët e KMD për realizimin me sukses të aktiviteteve të parashikuara.
4. Të printojë të gjithë materialet ndërgjegjësuere që do të shpërndahen gjatë aktiviteteve

### Përgjegjësitë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

1. Të kontribojë me materiale informuese dhe prezantime gjatë realizimit të aktiviteteve të parashikuara në kuadër të projektit **“Respektimi i të drejtave të viktimave të trafikimit në Shqipëri - TI JAPIM FUND STIGMËS”**.
2. Një përfaqësues i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të përfshihet në aktivitetet që do të realizohen për të transmetuar zërin e institucionit në çdo rast.

### Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Afati i kesaj marreveshje është një vjeçar, me të drejtë rinovimi me miratimin e të dyja paleve.

Kjo marrëveshje bëhet në dy kopje, në gjuhën Shqipe dhe hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit te saj nga palët

Firmosur me datë 26.02.2012

Organizata  
“Të Ndryshëm & Të Barabartë”

Mariana Meshi  
Drejtoreshë Ekzekutive



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi



Irma Baraku

Prot - 63/1